



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:300188

Datë: 17.05.2024

Numri i dokumentit: 05700276

AA.nr.533/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, e me bashkëpunëtore profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, F.R nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Rexhep Podvorica, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në me seli Prishtinë, me bazën juridike anulim të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3149/2019, të datës;23.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurit, Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3149/2019, i datës;23.05.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3149/2019, të datës;23.05.2023, është vendosur, *“I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.R, Prishtinë, kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë. II. ANULOHET vendimi i të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji Nr. V-1207-2019 i datës 27.11.2019, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale”*.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë i padituri, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3149/2019, i datës;23.05.2023, të anulohet dhe të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet

Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e të paditurit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të paditurit, Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji të datës 27.11.2019, paditësit i është refuzuar si e pa bazuar ankesa e datës; 18.11.2019 dhe paditura ka lënë në fuqi vendimin Nr.ZRRE/DMK_V_1803_05_18, i datës; 27.11.2019, me arsyetimin se lexuesi i KEK-ut nuk ka pasur qasje në leximin e shpenzimit mujor, janar 2013, dhe për këtë konsumatori duhet të faturohet me mesataren e shpenzimeve paraprake.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, më dt.31.12.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur kundër vendimit kontestues të paditurit, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Lidhur me këtë, neni 10 par.1 i LKA-së përcakton si në vijim: “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor”. Më tutje, neni 18 i LKA-së po ashtu ka përcaktuar se kush mund të ketë cilësinë e paditësit në konfliktin administrativ: “Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi fizik, personi juridik, Avokati i Popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesit publik, që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo ndonjë interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i bazuar në ligj”. Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të goditur me padi, gjykata fillimisht shqyrtoi bazën ligjore mbi të cilën është nxjerrë ky vendim. Vendimi i të paditurës ZRRE i referuar nga dispozitat ligjore të Ligjit dhe Rregullave të brendshme të ZRRE-së. Gjykata konstatimin e dhënë në Vendimin e kontestuar të paditurës sa i përket faturimit për muajin shkurt e faturuar në muajin mars 2013 në shumën 568.35 euro se kjo shumë është ngarkuar paditësi në formë paushallë, duke u thirr në procesverbalin e inspektimit nr.1746165 të datës 29.02.2016, gjendja e shpenzimit me njëhisorin elektrik nr.4194181 përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në programin e faturimit. Po ashtu edhe theksimet në vendim të paditurës se leximi dhe faturimi i shpenzimeve të energjisë eklektike të paditësi kanë qenë të rregullta përpos periudhës 01/2013, ku është faturuar paditësi pa matje/ paushallë, për gjykatën ky konstatim është veprim jo i drejtë për faktin se faturimi është bërë pikërisht për faturën dhe muajin kontestues në mënyrë paushallë me ngarkese të shpenzimeve të bazuar në gjendje jo reale vetëm në mënyrë paushallë. Edhe arsyetimi i të paditurës në vendim se paditësi shpenzime të energjisë elektrike të ngjashme ka pasur në periudhat para kontestuese si periudha e viti 2009 dhe 2010 janë veprime jo të rregullta nga e paditura sepse e paditura nuk ka mundur të vërteton gjendjen faktike reale për periudhën kontestuese duke u bazuar në periudhat para, për faktin se faturimi për muajin kontestues është bërë pa matje ndërsa për periudhat para kontestuese vërehen se janë shpenzime të matura e jo paushall nga Keku. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të energjisë elektrike dhe borxhit të faturuar të Kek-ut, e të cilin borxh e ka faturuar Kesco, e paditura në vendimin e vet nuk e ka argumentuar dhe arsyetuar se në bazë të cilës marrëveshje apo rregullore e ka bazuar të drejtën ligjore të*

Kesco me faturim të borxhit paditësin. Ndërsa sa i përket çështjes së parashkrimit ku e paditura në arsyetimin e vendimit ka theksuar ZRRE nuk është kompetente se a e dërgon Kesco borxhin e konsumatorit te përbaruesi dhe ZRRE ka qenë vetëm se a ka qenë faturat në rregull apo jo, gjykata konstaton se e paditura është dashur ta trajtoj në përputhej me ankesat dhe kundërshtimet e konsumatorit në ankesën e tij, duke e përfshirë edhe çështjen e parashkrimit. Gjykata duke pasur parasysh se borxhi për shpenzimet e energjisë elektrike është borxh periodik me që i njëjti arrin pas përfundimit të çdo muaji dhe me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) neni 360 par 1 Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, përcakton “1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;” dhe paragrafit 2 “ Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”, që do të thotë se referuar periudhës kontestuese, parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë. Lidhur me faktin e deklarimit të paditësit se kemi parashkrim, gjykata kishte parasysh LMD, ku me nenin 341 përcaktohet:” 2. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Me nenin 343 të LMD përcaktohet:” Parashkrimi lind, kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj”. Në NËNKREU 4 NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT Neni 368 të LMD Pranimi i borxhit përcaktohet:”1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit. Andaj bazuar në provat e dorëzuara dhe deklaratimet e paditurës në vendimin kontestues gjykata nuk ka mundur të, nuk mund të thuhet se është ndërprerë parashkrimi i këtij borxhi. Me nenin 369 të LMD përcaktohet: “Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”, kurse me nenin 372 të LMD përcaktohet:” Për ndërprerjen e parashkrimit nuk mjafton që kreditori ta ftojë debitorin me shkrim ose me gojë që ta përmbushë detyrimin”. Me nenin 2 paragrafi 2.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, përcaktohet:” Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Ndërsa me nenin 7.3 të këtij ligji, përcaktohet se: “Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarojnë”. Pasi që gjykata vërtetoi këto fakte mbi bazën e provave në shkresat e lëndës si dhe në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, vlerësoi se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, për shkak se nuk janë vërtetuar plotësisht gjendja faktike dhe rrjedhimisht është nxjerrë vendim jo i drejtë në pikëpamje të bazës ligjore. Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, me theks të veçantë ta shqyrton parashkrimin duke u bazuar në dispozitat ligjore të LMD dhe të rivlerëson edhe një herë pretendime te paditësit sa i përket faturimit të borxhit për muajin kontestues të faturuar pa matje/paushall, duke e mbështetur në marrëveshje apo rregullore dhe te merr parasysh Marrëveshjen mbi Inkasimin ndërmjet KEK dhe KKDFE dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë e të bazuar në ligj. Bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të të provuarit, nënkupton një detyrim për palët. Kjo lidhet me detyrimin për respektimin me përpikëri të procedurave ligjore të përcaktuara me ligj. Në këtë kuptim Gjykata vlerësoi edhe pretendimet

e të paditurës dhe konstaton se të njëjtat janë të pa bazuara, sepse me provat e administruara, konstatohet gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga këtu e paditura. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Lidhur me kërkesën e palës paditëse për shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së, me të cilin përcaktohet se secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se “Gjykata në mënyrë të gabuar e bënë konstatimin e gjendjes faktike në këtë çështje juridike, e si pasoj ka nxjerrë një përfundim të gabuar, i cili qartazi nuk është i bazuar në dispozita ligjore. Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuara pretendimet e të paditurës ZRRE, për faktin se me asnjë provë të vetme nuk janë provuar të njëjtat. Ndërkaq pretendimet e paditësit F.R i aprovoi si të bazuara”. Kolegji i apelit duke i vlerësuar këto pretendime ankimore, vëren se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurës janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kur ka konstatuar se “Edhe arsyetimi i të paditurës në vendim se paditësi shpenzime të energjisë elektrike të ngjashme ka pasur në periudhat para kontestuese si periudha e viti 2009 dhe 2010 janë veprime jo të rregullta nga e paditura sepse e paditura nuk ka mundur të vërteton gjendjen faktike reale për periudhën kontestuese duke u bazuar në periudhat para, për faktin se faturimi për muajin kontestues është bërë pa matje ndërsa për periudhat para kontestuese vërehen se janë shpenzime të matura e jo paushall nga Keku. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të energjisë elektrike dhe borxhit të faturuar të Kek-ut, e të cilin borxh e ka faturuar Kesco, e paditura në vendimin e vet nuk e ka argumentuar dhe arsyetuar se në bazë të cilës marrëveshje apo rregullore e ka bazuar të drejtën ligjore të Kesco me faturim të borxhit paditësin.”

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit “me vetë faktin që konsumatori nuk u kishte lejuar qasje punëtorëve të autorizuar të operatorit të shpërndarjes – KEK për leximin e shpenzimeve mujore që të kenë qasje në leximin e shpenzimeve në pikën matëse, të njëjtit e kanë faturuar konsumatorin me kilovatë të vlerësuar”. Kolegji i apelit i vlerëson këto pretendime ankimore po ashtu janë të pa qëndrueshme, sepse Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e të paditurit janë të pa bazuara, kjo për faktin se e paditura në vendimin e vet nuk e ka argumentuar dhe arsyetuar se në bazë të cilës marrëveshje apo rregullore e ka bazuar të drejtën ligjore të Kesco-s me faturim të borxhit për paditësin. Ndërsa sa i përket çështjes së parashkrimit ku i padituri në arsyetimin e vendimit ka theksuar ZRRE nuk është kompetente se a e dërgon Kesco borxhin e konsumatorit te përmbaruesi dhe ZRRE ka qenë vetëm se a ka qenë faturat në rregull apo jo, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura është dashur ta trajtoj në përputhej me ankesat dhe kundërshtimet e konsumatorit në ankesën e tij, duke e përfshirë edhe çështjen e parashkrimit.

Mbi këto arsye sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, e paditura do të mund ta faturonte borxhin në mënyrë paushallë për periudhën kontestuese 01/2013, vetëm nëse do të kishte marrëveshje

apo rregullore të bazuar në të drejtën ligjore, fakt të cilin e paditura nuk e ka ofruar as në procedurën administrative dhe as në procedurën e konfliktit administrativ, dhe bazuar në këtë Gjykata e shkallës së parë ka obliguar organin e paditur që në ri-procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykim e ankimuar, me theks të veçantë ta shqyrton parashkrimin duke u bazuar në dispozitat ligjore të LMD dhe të rivlerëson edhe një herë pretendime të paditësit sa i përket faturimit të borxhit për muajin kontestues të faturuar pa matje/paushall, duke e mbështetur në marrëveshje apo rregullore dhe të merr parasysh Marrëveshjen mbi Inkasimin ndërmjet KEK dhe KKDFE dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë e të bazuar në ligj.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ngase provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.533/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti